



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**  
(për publikim në SPE dhe buletinin e njoftimeve publike)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)  
BASHKIA MALLAKASTËR**

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) **“ARDMIR” shpk**, me NIPT K82509006P & **“KUPA” shpk**, me NIPT K51615512C, & **“ALBA KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT J61812013R, me adresë qendrore të përfaqësuesit të BOE **“ARDIMIR” shpk**, sipas QKB: Berat Ura Vajgurore KONISBALTE Lagjja " Konizbalte ", rruga kryesore, Leje Minerare Shfrytezimi ne Objektin e Gurit Gelqeror, Kodra e Konizbaltes

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-16587-08-20-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Punime për rehabilitimin e digës së rezervuarit të Gadurovës”**, me fond limit **67,632,735** (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e dymijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.54, datë 26 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

- 1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ARDMIR” shpk, me NIPT K82509006P & “KUPA” shpk, me NIPT K51615512C, & “ALBA KONSTRUKSION” shpk, me NIPT J61812013R, me ofertë ekonomike në shumën prej 64,964,175.15 (gjashtëdhjetë e katërmilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.**
- 2. Operatori Ekonomik (OE) “EVEREST” shpk, me NIPT J78311921L, me ofertë ekonomike në shumën prej 66,012,177 (gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e dymbëdhjetëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**
- 3. Operatori Ekonomik (OE) “PEPA GROUP GROUP” shpk, me NIPT L42215009L, me ofertë ekonomike në shumën prej 66,488,273.40 (gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzetë) lekë pa TVSH.**
- 4. Operatori Ekonomik (OE) “METEO”.SH.p.k, me NIPT L26310801C, me ofertë ekonomike në shumën prej 67,038,043 (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e tridhjetë e tetëmijë e dyzetë tre) lekë pa TVSH.**

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm, përkatësisht për arsyet:**

- 1. Operatori Ekonomik (OE) “EVEREST” shpk, me NIPT J78311921L, me ofertë ekonomike në shumën prej 66,012,177 (gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e dymbëdhjetëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi nuk ka paraqitur asnjë prej dokumentave të kërkuara në DST për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta dhe rrjedhimisht skualifikohet.**
- 2. Operatori Ekonomik (OE) “PEPA GROUP GROUP” shpk, me NIPT L42215009L, me ofertë ekonomike në shumën prej 66,488,273.40 (gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzetë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:
  - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, sa i takon madhësisë në vlerë të kontratës së ngjashme të paraqitur. Kontrata e vetme që është paraqitur, me objekt “Rikonstruksioni i kanalit fshati Iballë, Fushë Arrëz”, është në vlerën 28,955,364 lekë me tvsh ose 24,129,470 lekë pa tvsh, pra është më e vogël se vlera e kërkuar (30,000,000 lekë pa tvsh) në pikën 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit.**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/b, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës sipas shtojcës 3.  
Për këto arsye “PEPA GROUP” shpk skualifikohet.

**3. Operatori Ekonomik (OE) “METEO”.SH.p.k,** me NIPT L26310801C, me ofertë ekonomike në shumën prej **67,038,043** (gjashtëdhjetë e shtatëmilion e tridhjetë e tetëmijë e dyzetë tre) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave,** për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk përmbush detyrimin për plotësimin korrekt të shtojcës 2 “Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit”, të DST, ku përcaktohet “*Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.*”. Nga kontrolli i preventivit të paraqitur nga “METEO”.SH.p.k rezulton se në seksionin “C. Punime për rikonstruksionin e ujleshuesit të rezervuarit”, zëri me numër analize 3.2. “Preje bime me fi deri 10 cm skarpaten në sipërme dhe të poshteme të diges” është paraqitur pa sasi dhe nuk është kuotuar. Gjithashtu, zërit me numër analize 2.426/3 “Thyerje e hedhje copa betoni” dhe zërit me numër analize 3.245 “Beton M - 200 për mure të pusëtës” i’u është ndryshuar sasia, pra janë paraqitur me sasi të ndryshme nga sasi të përcaktuara në preventivin e punimeve të publikuar në SPE.

Në nenin 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, janë përcaktuar situatat e konsiderimit të ofertave të përgjegjshme/vlefshme. *Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

- “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit;*
- “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit; dhe*
- “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Në analizë të kësaj situate, rezulton se oferta e paraqitur nga “METEO”.SH.p.k, nuk është një ofertë e përgjegjshme/vlefshme, pasi jemi në situatën e shmangies së ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit.

Gjithashtu, edhe nëse ndryshimet e sasive do të klasifikoheshin si gabime aritmetike, duke i përlllogaritur çmimet e ofruara me sasi të sakta të përcaktuara në preventivin e publikuar në SPE, do të ishim para situatës së refuzimit të ofertës, pasi shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar (referuar përcaktimeve të paragrafit të dytë, të pikës 3, të nenit 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).

Për këto arsye “METEO”.SH.p.k skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë (BOE) “**ARDMIR**” shpk, me NIPT K82509006P & “**KUPA**” shpk, me NIPT K51615512C, & “**ALBA KONSTRUKSION**” shpk, me NIPT J61812013R, me adresë qendrore të përfaqësuesit të BOE “**ARDIMIR**” shpk, sipas QKB: Berat Ura Vajgurore KONISBALTE Lagjja " Konizbalte ", rruga kryesore, Leje Minerare Shfrytezimi ne Objektivin e Gurit Gelqeror, Kodra e Konizbaltes, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **64,964,175.15** (gjashtëdhjetë e katërmilion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë pesëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

(me urdhër për delegim kompetence)

**ZV/KRYETARI**

**Guri Nuhaj**